

VENDIM
Nr. 7, datë 19.1.2017

**MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË “RREGULLAT E PÛRKOHSHME TË
TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, MIRATUAR ME VENDIMIN
NR. 139, DATË 15.8.2016 TË BORDIT TË ERE-s**

Në mbështetje të neneve 16; 19, germa “a”; dhe 98, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike, në lidhje me disa ndryshime në “Rregullat e përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Në nenin 98, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike duhet të jenë në harmoni me Modelin e Tregut dhe miratohen nga ERE pas propozimit të OST sh.a.

- ERE, me vendimin nr. 151, datë 30.9.2016, pika 2 e tij, filloi procedurat për rishikimin e “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 139, datë 15.8.2016, të Bordit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 705 prot., datë 5.10.2016, ERE ka ftuar palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre në lidhje me pikat e propozuara për rishikimin e “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 139, datë 15.8.2016, pranë subjekteve: MEI, KESH sh.a., OST sh.a., OSHEE sh.a., Autoritetit të Konkurrencës, AAES, FIAA, Shoqata e Prodhuesve të Vegjël, AREA, si dhe Energji Ashta sh.p.k.

- Shoqëria KESH sh.a., me shkresën e saj nr. 8286/1 prot., datë 14.11.2016 ka përcjellë në ERE sugjerimet dhe komentet në lidhje me vendimin nr. 151, datë 30.9.2016, “Mbi rishikimin e rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”.

- ERE, në datën 20.12.2016, zhvilloi një seancë dëgjimore midis përfaqësuesve të OST sh.a. dhe KESH sh.a., për të diskutuar në lidhje me qëndrimin e palëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë disa ndryshime në “Rregullat e përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 139, datë 15.8.2016, si më poshtë:

- Kapitulli II, në pikën II.2.2, paragrafi “viii”; - OST-ja, në funksionin e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit do të ketë të drejtën për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të transmetimit nga tregtarët”, - hiqet “nga tregtarët”.

- Në kapitullin V “Kontratat dhe tarifat mes pjesëmarrësve të ndryshëm të tregut të parregulluar janë:” - hiqet fjala “tarifa”, shtohet “të parregulluar”.

- Në kapitullin V, paragrafin “vi” “Rregullat për kontratat dypalëshe”, në pikën V.1 - vi) kontratat për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve dhe shërbimeve ndihmëse në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes.” - shtohet “dhe shërbimeve ndihmëse”.

- Në kapitullin III, të pikës III.2, paragrafi iv, - një kopje të bilancit të fundit vjetor të certifikuar nga organet e tatimtaksave - bëhet “një kopje të certifikuar të bilancit të fundit vjetor dhe të depozituar në organet e tatimtaksave”.

- Në kapitullin VIII.2.2 - ERE do të miratojë çmimet e rregulluara për njësitë e gjenerimit të ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik - shtohet “deri në krijimin e tregut të balancimit ose kur parashikohet ndryshe nga aktet e tjera të ERE”.

- Në kapitullin VIII.3, paragrafi ii – nga “tarifat e mundshme të importit dhe eksportit ose energjisë gjatë dimrit në avancë” – bëhet “Çmimet e mundshme të energjisë në treg gjatë dimrit në avancë/dimrit pasardhës”.

- Në pikën XIV.4.2, të Rregullave, zëvendësohet termi “Furnizues Publik me Shumicë” me “Furnizuesi i Shërbimit Universal”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti